

Vendim nr. 244 datë 30.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar

në datën 30.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (T) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **TAHIR MUÇA, AISHE MUÇA, MAKSUT MUÇA, SEDEFKE MUÇA, ÇLIRIM MUÇA, SAUD MUÇA,** përfaqësuar nga avokat Kadri Isufaj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5268, datë 04.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1 shkronja “i” dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi B.M., palë paditëse e kundërpaditur në procesin e kundërshtuar nëpërmjet këtij ankimi kushtetues individual, si banor i fshatit Lejcan të Komunës Ostren, rrethi Bulqizë, i është drejtuar me kërkesë ish-këshillit të komunës për marrjen e ujit të pijshëm. Këshilli i komunës Ostren (*Këshilli*), me vendimin nr. 34, datë 14.09.2012 (*vendimi nr. 34/2012*), ka vendosur pranimin e kërkesës së paditësit/të kundërpaditur, shtetasit B.M.

2. Për ankimin e disa banorëve të fshatit Lejcan, Këshilli, me vendimin nr. 46, datë 01.10.2013, ka vendosur revokimin e vendimit nr. 34/2012. Gjithashtu, Këshilli, me vendimin nr. 47, datë 01.10.2013, ka vendosur furnizimin me ujë të pijshëm nga burimi “Përroi i Alko Matës”, lagja që përbëhet nga shtëpitë e banorëve Tahir Muça (një prej kërkuessve), A.K. E.M. dhe H.M. Për këtë arsye, pala paditëse e kundërpaditur, duke mos qenë dakord me këto vendime të Këshillit, i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi, me objekt shfuqizimin e tyre.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4427, datë 24.07.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është prishur nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 2685, datë 10.12.2015, e cila ka vendosur dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me tjetër trup gjykues.

4. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4962, datë 25.10.2016, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi i kundërpaditur dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, vendimeve nr. 46 dhe 47, datë 01.10.2013 të Këshillit, si dhe rrëzimin e kundërpadisë së paraqitur nga të paditurit/kundërpaditës, si të pabazuar në ligj e në prova. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuessi Tahir Muça.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 297, datë 27.04.2023, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 4962, datë 25.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të

vendimit nr. 46, datë 01.10.2013 të Këshillit. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të kërtimeve në padi, si dhe për të paditurin Tahir Muça. Rrëzimin e kundërpadisë.”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuessit, si dhe paditësi B.M.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5268, datë 04.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve, për shkak se nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

7. Në datën 16.06.2025 (*sipas shënimit të shërbimit postar*), kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në datën 17.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuessve

8. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se:

8.1. U është cenuar parimi i barazisë përpara ligjit, për shkak të përdorimit të termave ekstraligjorë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, për mënyrën e shqyrtimit të rekurseve, e cila të krijon përshtypjen se duhet patjetër që rekursat e periudhave të fundit të shqyrtohen në këtë mënyrë të nxituar, duke dëmtuar cilësinë e vendimeve. Kushtetuta nuk i ka dhënë asnjë tagër kolegjeve të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga 3 gjyqtarë, të bëjnë interpretime për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

8.2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit u janë referuar ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, në një kohë që ky ligj nuk ka qenë në bazën ligjore të padisë ose të kundërpadisë. Këshillat komunalë dhe këshillat bashkiakë nuk mund të quhen organe kolegjiale, pasi vendoset vetëm me votim. Të gjithë vendimet e dhëna nga ish-këshillat e komunave, që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore”, konsiderohen si vendimeve të mbështetura nga ky ligj.

8.3. Vendimit të Këshillit nr. 34/2012 i mungon kërkesa e motivuar, procesverbali i mbledhjes i nënshkruar nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, sikurse mungojnë edhe disa nënshkrime. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë vlerësuar aktet më të rëndësishme, për të cilat kishte kërtime për pavlefshmëri absolute, pasi nuk ishin në formën e kërkuar nga ligji. Po kështu, ato gjykata kanë interpretuar gabim dispozitat ligjore, në kuptim të nenit 116/c të Kodit të Procedurave Administrative.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarve

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuar të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuar. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

11. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuar në mbështetje të ankimit kushtetues individual, vëren se, në thelb, ata kanë

pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka përdorur terma ekstraligjorë në vendim, duke dëmtuar cilësinë e tij; gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit u janë referuar një ligji, i cili nuk ishte në bazën ligjore të kërkesëpadisë; si dhe se ato gjykata nuk kanë vlerësuar aktet më të rëndësishme, për të cilat kishte kërtime për pavlefshmëri absolute dhe kanë interpretuar gabim dispozitat ligjore.

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Referuar pretendimeve të kërkuësve si më sipër, Kolegji konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Po kështu, Kolegji vëren se kërkuësit nuk kanë sjellë asnjë argument konkret kushtetues për cenimin së drejtës kushtetuese të tyre për një proces të rregullt ligjor. Në kushtet që kërkuësit nuk kanë arritur të argumentojnë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat në zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji çmon se këto pretendime mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuësit nuk legjitimohen *ratione materiae*.

14. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji çmon të mos ndalet në analizën e mëtejshme të plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues individual të kërkuësve.

15. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, ankimi kushtetues individual i kërkuësve nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.